



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 41 dt. 22.07.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 22.07.2014, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. *Miratimin e projektit të restaurimit “Xhamia Mbret” Berat, me vërejtjet e mëposhtme:*

- Të bëhen sondazhe në fasadë, për të parë teknikën e muraturës poshtë suvasë. Vendimi nëse fasada do të suvatohet ose jo do të merret pas rezultatit të këtyre sondazheve dhe dokumentacionit përkatës. Vendimi do të merret nga KKR .
- Të parashikohet në projekt heqja e depozitave të ujit në hajat.
- Të parashikohet sistemimi i sheshit dhe shtrimi me kalldrëm i hapësirës ku aktualisht ndodhet një lulishte.
- Gurët e varreve të sistemohen dhe të ekspozohen.
- Në qoshet e fasadës (hajat) dhe në kornizat e dritareve të cilat janë aktualisht të suvatuara të bëhen sondazhe për muraturën poshtë. Nëse rezulton me muraturë me gurë të rregullt këto pjesë të lihen të pasuvatuara.
- Kangjellat metalike të dritareve, nëse janë të punuara me hekur të rrahur të mos hiqen por të restaurohen në vend.

2. *Miratimin e projektit të restaurimit “Xhamia e Beqarëve” Berat, me vërejtjet e mëposhtme:*

- Për tavanin e kësaj xhamie u la të pastrohet tavani ekzistues nga llaku dhe ti bëhet ndërhyrje konservuese tavanit ekzistues (**pra të mos hiqet tavani ekzistues**).
- Fondi i tavanit mund të përdoret për sistemimin e kalldrëmeve të jashtme.
- Në interior është parashikuar ndërtimi i një mimeri, i cili duhet të sillet i detajuar në projekt.

3. *Miratimin e projektit të restaurimit "Teqeja e Helvetive" Berat, me vërejtjet e mëposhtme:*

- Të bëhet sondazh për godinën e bibliotekës dhe nëse gjenden themelet e saj të dokumentohen, të konservohen dhe të jenë të lexueshme në sipërfaqe.
- Të bëhen përforcimet për pjesën e murit me çarje nëse nuk është parashikuar në projekt.
- Në ambjentin ku ka qenë vendi i dy varreve, në dysHEME, të evidentohet në mënyrë skematike vendndodhja e tyre.

4. *Miratimin e projektit të restaurimit "Xhamia e E'them Beut" Tiranë, me vërejtjet e mëposhtme:*

- Projekti të plotësohet me detaje për vetratën e propozuar.
- Çatitë trekëndore të mbulohen me tjegulla.
- Restaurimi i çatisë së hajatit të bazohet në fotot e vjetra të objektit (detajet e strehës).
- Pas pastrimit të suvasë me llaç çimento, Xhamia të risuvatohet.
- Ngjyra e fasadës do të vendoset në IMK.
- Projekti të plotësohet me detajin e derës së propozuar, (të bazohet në fotot e vjetra të arkivës)

Për të gjitha xhamitë, dekoracioni në majë të konit të minares (alem) të restaurohet origjinali dhe të mos vendoset i ri.

Për pikturat murale - të mos parashikohen në projekt plotësimet e lakunave të mëdha (hapësira bosh).

5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, nr. 76, Kinostudio, Tiranë, Shqipëri,

Tel. 04 4504153; 04 4504152

Email: info@imk.gov.al